

Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr. 13 Regj.Themeltar, Datë 18.04.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Indrit Sefa.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ.

Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 53, datë 10.04.2023 të KAS për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 48, datë 07.04.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Shfuqizimi pjesërisht i vendimit nr. 300, datë 05.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “*Verifikimi i deklarimeve në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023*”.

Ndalimin e kandidimit të Kandidatit për Kryetar Bashkie të Mallakastrës shtetasit Qerim Ismail Ismailaj të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë..

OSE

Detyrimin e KAS të marrë vendim dhe të shprehet në lidhje me ankimin e paraqitur nga ana e Partia Demokratike e Shqipërisë për vendimin nr. 300, datë 05.04.2023.

Më datë **19.04.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Blerona Hasa (Relatore);**
- 2. Marsela Dervishi (Anëtare);**
- 3. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 4. Emona Muçi (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare).**

Me Urdhër datë 19.04.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **24.04.2023, ora 15:00**, për zhvillimin e seancës gjyqësore në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. “Ismail Qemali”, Tiranë.

Tiranë, më 19.04.2023.

Gjykata Administrative e Apelit